



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 135, Datë 10.08.2020

MBI

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TE ERE NR. 71, DATË 22.04.2020, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “KALISI HYDROPOWER” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-ET “VELESHICA 1” ME KAPACITET TË INSTALUAR 5801 KW DHE “VELESHICA 2”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 8116 KW, ME KAPACITET TOTAL TË INSTALUAR 13917 KW”.

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 113, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE Nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e datës 10.08.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 94/3 Prot, datë 04.08.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqytjes, mbi kërkesën e shoqërisë “KALISI HYDROPOWER” sh.p.k., mbi plotësimin e kushtit të vendosur në pikën 3 të vendimit Nr. 71, datë 22.04.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë “KALISI HYDROPOWER” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin Nr. 71, datë 22.04.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë “KALISI HYDROPOWER” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “VELESHICA 1” me kapacitet të instaluar 5801 kW dhe “VELESHICA 2”, me kapacitet të instaluar 8116 kW, me kapacitet total të instaluar 13917 kW”, vendosi:
 1. Të licencojë shoqërinë “KALISI HYDROPOWER” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Veleshica 1”, me kapacitet të instaluar 5801 kW, si dhe “Veleshica 2” me kapacitet të instaluar 8116 kW, me kapacitet total 13917 kW, për një afat 30-vjeçar.
 2. Shoqëria “KALISI HYDROPOWER” sh.p.k., të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar të qirasë për truallin ku do të ushtrohet veprimtaria jo më vonë se 3 (tre) muaj përpara përfundimit të afatit të saj.
 3. Shoqëria “KALISI HYDROPOWER” sh.p.k., të depozitojë në ERE jo më vonë se një muaj nga përfundimi i epidemisë Covid-19 vërtetimet e lëshuara nga prokuroria dhe gjykata e rrethit të Tiranës për shoqërinë dhe administratorin e saj.
 4. Mos plotësimi i kushteve të këtij vendimi përbën shkak për rishikimin e tij.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, me shkresën nr. 655, datë 22.04.2020, u njoftua shoqëria “KALISI HYDROPOWER” sh.p.k. në lidhje me vendimmarrjen e ERE-s për licencimin në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- Në zbatim të vendimit të bordit të ERE-s Nr. 51, datë 26.03.2020, u njoftua shoqëria në lidhje me detyrimin për të depozituar në ERE jo më vonë se një muaj nga përfundimi i pandemisë COVID-19 (brenda datës 23.07.2020), vërtetimet e lëshuara nga gjykata dhe prokuroria e rrethit të Tiranës për shoqërinë dhe administratorin e saj.
- Më tej, me shkresën e ERE-s nr. 655/1 prot, datë 17.07.2020, është rikujtuar shoqëria në lidhje me plotësimin në afat të detyrimit të sipërcituar
- Në përgjigje, me shkresën e datës 22.07.2020, protokolluar në ERE, me nr. 655/2 prot, datë 22.07.2020, shoqëria ka depozituar në ERE vërtetimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, nga të cilët nuk rezulton të ketë proces penal për shoqërinë dhe administratorin e saj, si dhe vërtetimet e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, nga të cilët nuk rezulton të ketë procedim penal në ngarkim të shoqërisë dhe të administratorit të saj.
- Sa më sipër, rezulton se shoqëria ka depozituar në ERE të gjithë dokumentacionin e munguar, duke plotësuar kështu kushtin e vendosur në pikën 3 të vendimit Nr. 71, datë 22.04.2020.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Pika 3 e vendimit të bordit të ERE Nr. 71, datë 22.04.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë “KALISI HYDROPOWER” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “VELESHICA 1” me kapacitet të instaluar 5801 kW dhe “VELESHICA 2”, me kapacitet të instaluar 8116 kW, me kapacitet total të instaluar 13917 kW”, shfuqizohet.
2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI